



AKT-THEMELIMI

-----  
PER  
---

SHOQERINE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

-----  
"EDICOM" SH.P.K  
-----

N D E R M J E T :

1. Personit Giovanni Degennaro, banues në adresën: Via "Cardinale Ciasca" N 9, Bari.
2. Personit Canio Scianatico, banues në adresën: Via "Prospero Petroni" N 30 Bari.
3. Personit Luigj Aleksi, banues në adresën: Lagja N. 4, Rruga "Prokop Meksi" 166 Durrës.
4. Personit Spartak Çaušolli, banues në adresën: Rruga "Islam Alla", Pall. 71/2, Ap. 17, Tiranë.

PALET BIEN DAKORD PER SA VIJON:

NENI 1

Të krijojnë një Shoqëri Tregëtare me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K.).

Shoqëria do të emërohet: "EDICOM" Sh.p.k.

Shoqëria do t'a ketë qendrën e saj në Republikën e Shqipërisë, në qytetin e Tiranës në Pallatin e Madh të Kulturës në Sheshin "Skëndërbej" dhe do të ketë kohëzgjatje për një periudhë prej 20 vjetësh, afat i cili mund të zgjatet më tej në marrëveshje unanime të ortakëve, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 2

Në bazë të legjislacionit shqiptar, shoqëria është person juridik shqiptar dhe veprimtaria e saj do të zhvillohet në përputhje me këtë akt, me statutin që bashkalidhet dhe me dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar.

NENI 3

Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet që rrjedhin nga veprimtaria industriale, ekonomike e tregëtare që ortakët zhvillojnë në mënyrë të pavarur.

- 2 -

Shoqëria përgjigjet vetëm (eskluzivisht) me kapitalin e saj.

#### NENI 4

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë: Shërbime e asistencë teknike, projektimi e zbatimi i punimeve të ndërtimit, i ndërtimit-montimit të objekteve për të gjitha fushat që i lejon licenca profesionale.

- Prodhimi i gëlqeres, i allçisë, i betonit të gatshëm për përdorim, i llaçit, i të gjitha prodhimeve prej betoni, i zhavorrit dhe i çimentos, i parafabrikimit të produkteve të tjera të përpunimit të mineraleve jometalorë dhe joenergjistik.

Aktivitetet e mësipërme dhe të transportit mund të kryhen si për llogari të shoqërisë, ashtu edhe për të tretët, duke përfshirë edhe dhënien me qira të mjeteve, makinerive e pajisjeve që disponon shoqëria.

#### NENI 5

Për arritjen e objektivave të shoqërisë, palët bien dakort të bashkojnë kapitalet e tyre respektivisht, në funksion të organizimit dhe zhvillimit të veprimtarisë së tyre të përbashkët.

Kapitali shoqëror i Shoqërisë do të përbëhet prej 10.000.000 (dhjetëmillion) lekë, i cili ndahet si vijon:

- Giovanni Dagennaro do të marrë pjesë në kapitalin shoqëror të themelimit me 3.500.000 (tremillion e pesëqindmijë) lekë ose 3.500 kuota.

- Canio Scianatico do të marrë pjesë në kapitalin shoqëror të themelimit me 3.500.000 (tremillion e pesëqindmijë) lekë ose 3.500 kuota.

- Luigj Aleksi do të marrë pjesë në kapitalin shoqëror të themelimit me 2.000.000 (dymillion) lekë ose 2.000 kuota.

- Spartak Çauholli do të marrë pjesë në kapitalin shoqëror të themelimit me 1.000.000 (njëmillion) lekë ose 1.000 kuota.

#### NENI 6

Kapitali shoqëror mund të ndryshojë sipas nevojave të shoqërisë në marrëveshje midis palëve.

Kapitali i vënë respektivisht do të rregjistrohet në llogaritë e shoqërisë dhe, secilës palë do t'i jepet një certifikatë për



kuotën e derdhur.

NENI 7

Shoqëria do të fillojë nga veprimtaria e saj në momentin e rregjistrimit të saj sipas dispozitave ligjore të shtetit shqiptar.

Të ardhurat që do të realizojë shoqëria, pasi të janë zbritur shpenzimet e të janë paguar taksat ligjore, do të tatohen sipas dispozitave të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Fitimi i mbetur do të ndahet ndërmjet ortakëve në raport me sa është parashikuar në nenin 5 të kësaj kontrate.

NENI 8

Shoqëria administrohet nga një Këshill Administrativ që u emërua në mbledhjen e parë të Asamblesë e përbërë nga katër persona, si më poshtë:

- Av. Giovanni Degennaro
- Luigj Aleksi
- Spartak Çaušolli
- Canio Scianatico

të cilët pranojnë detyrën e administratorit dhe ata emërojnë si president Av. Giovanni Degennaro.

NENI 9

Ortakët janë të detyruar të ruajnë sekretin e dokumentacionit, të know-how dhe të eksperiencës së këmbyer e të realizuar brenda veprimtarisë së shoqërisë, duke evituar përhapjen e saj goftë edhe pjesërisht.

Ortakët janë përgjegjës për konsekuencat e dëmshme nga shkelja e këtij detyrimi, kur kjo shkelje është rezultat i një veprimi të kryer me dashje ose në formën e neglizhencës.

NENI 10

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen në mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet Gjykatës së Rrethit të Tiranës.

NENI 11

Norma (nene) të detajuara që kanë të bëjnë me funksionimin e shoqërisë, janë përcaktuar në statutin që i bashkëlidhet kësaj

- 4 -

kontrate.

NENI 12

Ky akt u përpilua në katër kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe italiane që kanë vlerë të barabartë juridike.

Tiranë, më 18.04.1994

P A L E T

Luigj Aleksi  
Spartak Causholli

*[Signature]*

Giovanni Degennaro  
Canio Scianatico

*[Signature]*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E DREJTESISE  
NOTERIA  
Nr. 8203 Rep.  
Nr. 5284 Kol.

V E R T E T I M

Sot me dt. .5.I994 , para meje noteres , u paraqiten personalisht : z.Giovanni Degennaro, z.Canio Scianatico, z.Luigj Aleksi dhe z. Spartak Causholli, per identitetet e te cileve u sigurova nga leternjoftimet e tyre personale, madhere , me zotesi te plote juridike per te vepruar , te cilet me deklaruan se jane dakort me permbytjen e ketij akti themelimi , e nenshkruejne regullisht perpara meje dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit.

N O T E R E

*Siguroca Spokes*





## S T A T U T

### I SHOQERISE TREGETARE

### "EDICOM" SH.P.K"

#### KAPITULLI 1

##### EMERTIMI - OBJEKTI - SELIA - KOHEZGJATJA.

###### NENI 1

Eshtë krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin: "EDICOM" Sh.p.k".

Shoqëria është person juridik shqiptar në bazë të dekretit të ligjit Nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregëtare" dhe të ligjit Nr.7540, datë 04.08.1992 "Për investimet e huaja".

Shoqëria gëzon të drejtën si person juridik shqiptar duke filluar nga data kur organet kompetente shqiptare kanë dhënë miratimin e krijimit të saj.

###### NENI 2

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjisla-cionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentet e krijimit të saj (kontrat e statut).

###### NENI 3

Shoqëria krijohet për të zhvilluar aktivitetin si vijon:

- Shërbime e asistencë teknike, projektimi e zbatimi i punimeve të ndërtimit, i ndërtimit-montimit të objekteve për të gjitha fushat që i lejon licenca profesionale.
- Prodhimi i gëlqeres, i allçisë, betonit të gatshëm për për-

dorim, i ilaqit, i të gjitha prodhimeve prej betoni, zhavorrit dhe çimentos, parafabrikimit të produkteve të tjera të përpunimit të mineralevë jo metalore dhe jo energjetike.

Aaktivitetet e mësipërme dhe të transportit mund të kryhen për illogari të shoqërisë, ashtu edhe për të tretët, duke përfshirë edhe dhënien me gira të mjeteve, makinerive e të pajisjeve që disponon shoqëria.

NENI 4

Shoqëria e ka selinë në Tiranë. Asamblea e shoqërisë ka të drejtë të krijojë ose të anullojë seli sekondare, filiale, agjensi dhe përfaqësi pa kufizim territorial.

NENI 5

Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet që rrjedhin nga veprimtaria industriale, ekonomike e tregtare që ortakët zhvillojnë në mënyrë autonome.

Shoqëria përgjigjet vetëm (ekskluzivisht) me kapitalin e saj.

NENI 6

Selia e ortakëve, për q'ka i takon raporteve të tyre me shoqërinë për të gjitha efektet e ligjit, është ai që rezulton nga libri i ortakëve.

NENI 7

Kohëzgjatja e shoqërisë është fiksuar deri më 01.04.2014 dhe mund të prishet para afatit ose te zgjatet një ose disa herë me vendim të Asamblesë.



- 3 -

## KAPITULLI 11

### KAPITALI

#### NENI 8

Kapitali është përcaktuar në lek 10.000.000, mund të rritet me vendim të Asamblesë respektivisht me normat përkatëse në fuqi dhe është ndarë në kuota që rezultojnë nga "libri i ortakëve" të barabarta me 1000 lek.

#### NENI 9

Për arritjen e objektivave të shoqërisë, palët bien dakort të bashkojnë kapitalet e tyre respektivisht, në funksion të organizimit dhe zhvillimit të veprimtarisë së tyre të përbashkët.

Kapitali shoqëror i shoqërisë do të përbëhet nga 10.000.000 (dhjetëmillion) lekë.

- Giovanni Degennaro do të marrë pjesë në kapitalin shoqëror të themelimit me 3.500.000 (tremilione pesëqindmijë) lekë e barabartë me 3.500 kuota.

- Canio Scianatico do të marrë pjesë në kapitalin shoqëror të themelimit me 3.500.000 (tremilione pesëqindmijë) lekë e barabartë me 3.500 kuota.

- Luigj Aleksi do të marrë pjesë në kapitalin shoqëror të themelimit me 2.000.000 (dymillion) lekë e barabartë me 2.000 kuota.

- Spartak Çaušollı do të marrë pjesë në kapitalin shoqëror të themelimit me 1.000.000 (njëmillion) lekë e barabartë me 1.000 kuota.

- 4 -

**NENI 10**

Kuotat janë personale dhe nuk mund të jenë kurrë të përfaqësuar nga letra me vlerë, sipas nenit 45 të ligjit 7638/92.

Shoqëria do të lëshojë një certifikatë secilit ortak që vërteton cilësinë e tij si ortak dhe vleftën e kuotës që ai zotëron.

**NENI 11**

Të drejtat e bashkëpronarëve, për kuotën e pasurisë së përbashkët të më shumë personave, duhet të ushtrohen nga një përfaqësues i përbashkët.

**NENI 12**

Ortakët, me kërkesën e këshillit administrativ të shoqërisë, por unanimisht dhe në proporcion të drejtë me kuotat që zotërojnë mund të vënë në dispozicion të shoqërisë fonde të tjera ose mjete financiare në llogari të kapitalit për të lejuar më mirë arritjen e objektit shoqëror.

Asamblea mund të vendosi herë pas here kushtet e shlyerjes të këtyre pagesave të thëna mësipër.

**NENI 13**

Kuotat e kapitalit shoqëror janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

**NENI 14**

Ortakëve i është rezervuar e drejta e parablerjes së kuotave ose të pjesës së kuotës të lëshuar eventualisht nga ortakët.

E drejta e parablerjes kur lëshohet kuota e vet ose një pjesë e saj duhet të zbatohet brënda tridhjet ditëve nga data e njoftimit, të bërë nëpërmjet letrës rekomande secilit prej ortakëve dhe vetë shoqërisë.

**NENI 15**

Përveç të drejtës së parablerjes rezervuar ortakëve, kuotat e kapitalit shoqëror mund t'i transferohen të tretëve që nuk bëjnë pjesë në shoqëri me modalitetet e parashikuara prej nenit 47 të ligjit 7638/92.

**NENI 16**

Pjesët e kapitalit themelor janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë lirisht të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve si dhe ndërmjet paraardhësve e pasardhësve.

**NENI 17**

Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vértohen me një akt notarial.

Shoqëria ose të tretët duhet të respektojnë këto transferime sapo t'i bëhen të ditura asaj.

**NENI 18**

Derdhjet relative në kuotat shoqërore kërkohen nga këshilli administrativ në afatin e në mënyrën që ai ka vendosur, duke përcaktuar penalitetet dhe sankzionet paraprake për vonesën.

### KAPITULLI III

#### ASAMBLEA

##### NENI 19

Asamblea regullisht e thirur përfaqëson tërësinë e ortakëve dhe vendimet e saj, të mara në përputhje me ligjin dhe këtë statut, janë të detyrueshme për gjithë ortakët.

##### NENI 20

Asamblea e ortakëve mund të thiret në selinë e shoqërisë ose në një vend tjeter të treguar në njoftimin e thirjes.

##### NENI 21

Këshilli administrativ organizon thirrjen menjëherë të Asamblesë së ortakëve aq herë sa ortakët që përfaqësojnë të paktën 1/10 e kapitalit shoqëror bëjnë kërkesë nëpërmjet një letre rekomande për çështjet që do trajtohen.

##### NENI 22

Cdo ortak ka të drejtën e një vote për çdo 1000 lekë të kuotës. Në se kuota është shumfish i kësaj shifre (1000 lekë), ortaku ka të drejtën e aq votave për çdo 1000 lekë.

##### NENI 23

Thirjet e Asamblesë organizohen nën kujdesin e këshillit administrativ nëpërmjet letrës rekomande dërguar ortakëve të paktën 15 ditë përpara kësaj mbledhje në adresat e asambleistëve që rezultojnë në librin e ortakëve.



- 7 -

Në letër duhet të tregohet vendi, dita, ora e mbledhjes dhe rendi i ditës.

Ekspertët kontabël të autorizuar, nëse janë të emëruar duhet të njoftohen për mbledhjen e Asamblesë së ortakëve në të njëjtat mënyra si mësipër, për t'i kofirmuar të drejtën përmarrë pjesë në këtë asamble.

Asamblea mund të thritet rregullisht, sipas nenit 57 të ligjit 7638/92, edhe në mungesë të formaliteteve të përmëndura mësipër në rast se janë të pranishëm ose i përfaqësuar i gjithë kapitali shoqëror.

#### NENTI 24

Çdo ortak që ka të drejtë të marri pjesë në asamble mund të përfaqësohet edhe nga një subjekt jo ortak. Autorizimi i delegimit, mund të jepet për thirje të vëganta me fuqinë edhe për thirje të mëtejshme, duhet të dorëzohet me shkrim dhe këto dokumenta përkatëse duhet të ruhen pranë shoqërisë.

#### NENTI 25

E drejta e marjes pjesë në Asamblenë e Ortakëve edhe të të deleguarve, duhet të jetë e vërtetuar dhe e njobur nga presidenti i vetë Asamblesë.

#### NENTI 26

Delegimi për të marrë pjesë në Asamblenë e ortakëve nuk mund të jepet pa shënuar emrin e përfaqësuesit.

Përfaqësuesi eventualisht mund të zëvendësohet vetëm nga

personi shprehimisht dhe paraprakisht i vërtetuar në delegim.

NENI 27

Asamblea drejtohet nga presidenti i këshillit administrativ. Në mungesë, asamblea e zgjedh vetë presidentin.

NENI 28

Presidenti ndihmohet nga një sekretar edhe jo ortak e nëse është e nevojshme me vendim të presidentit, nga dy vëzhgues të zgjedhur ndërmjet ortakëve.

NENI 29

Vendimet e asamblesë duhet të shënohen në proces-verbal të firmosur nga presidenti dhe nga sekretari.

Kur këshilli administrativ e quan të domosdoshme, proces-verballi duhet të jetë redaktuar nga një noter, që, në këtë rast bën punën edhe të sekretarit.

NENI 30

Vendimet e asamblesë duhet të meren me votim të hapur, ndërsa emërimi i pozitave shoqërore bëhet shprehimisht me gojë ose me votim të fshehtë.

NENI 31

Asamblea e ortakëve vendos rregullisht me votën e ortakëve që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e kapitalit shoqëror.

Edhe nëqoftëse ortakët thërriten në mbledhjen e dytë vendimet do të merren me votën e ortakëve që përfaqësojnë më shumë se

gjysmën e kapitalit shoqëror.

**NENI 32**

Në rastin e ndryshimit të statutit e të kontratës së krijimit asamblea vendos rregullisht, në mbledhjen e parë e të dytë, me votën e ortakëve që përfaqësojnë të paktën tre të katërtën e kapitalit shoqëror.

**KAPITULLI IV**

**ORGANI ADMINISTRATIV**

**NENI 33**

Shoqëria administrohet, sipas asaj që është vendosur nga asamblea, me votën e ortakëve që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e kapitalit shoqëror, nga një këshill administrativ i përbërë nga tre deri në nëntë pjestar, që mund të zgjidhen dhe jashtë bashkësisë së ortakëve nga asamblea për një kohë të papercaktuar ose për një periudhë që asamblea e vendos shprehimisht me aktin e emërimit.

**NENI 34**

Këshilli Administrativ zgjedh në gjirin e vet presidentin, zëvendëspresidentin që zëvendëson presidentin në rastin e mungesës ose të pengesës si dhe një sekretar goftë edhe të huaj.

**NENT 35**

Në rast se për dorëheqjen ose për raste të tjera mungon shumica e administratorëve, duhet të prishet gjithë këshilli dhe, rrjedhimisht, duhet të thiret pa vonesë asamblea në emër të të



gjithë administratorëve.

NENI 36

Këshilli administrativ mblidhet si pranë selisë së shoqërisë, ashtu edhe diku tjetër të gjitha herët kur presidenti e gjykon të nevojshme.

NENI 37

Këshilli administrativ thirret nga presidenti me njoftim të shkruar, të paktën shtatë ditë para mbledhjes, për secilin administrator.

NENI 38

Këshilli administartiv, në mungesë të formalitetave të nenit 35, vendos regullisht me prezencën e të gjithë administratorëve.

NENI 39

Vendimet e këshillit administrativ do të quhen të vlefshme kur janë marë me shumicën e votave dhe me prezencën efektive të të shumicës së anëtarëve.

NENI 40

Një anëtar i këshillit administrativ mund të përfaqësohet me anë të delegimit të shkruar.

NENI 41

Anëtarëve të këshillit administrativ i përket një shtesë rroge vjetore e përcaktuar nga asamblea e ortakëve, si dhe shlyerja e shpenzimeve të rezervuara për kryerjen e detyrave.

- 11 -

NENI 42

Asamblea e ortakëve ka mundësi t'i japi këshillit administrativ, me vendim përkatës, një shtesë të pagës vjetore për shpenzimet e përfaqësisë që mbahen për llogari të shoqërisë.

NENI 43

Anëtarët e Këshillit Administrativ janë të thirur nga asamblea në çfardolloj kohe me votën e aq ortakëve që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e kapitalit shoqëror, ashtu siç është përcaktuar në nenin 55 të ligjit 7638/92.

Eshtë e drejta e administratorëve për dëmshpérblim, nëse thirja e Asamblesë bëhet pa arsyë të drejtë.

NENI 44

Këshilli administrativ është i veshur me funksione të gjera për administrimin e zakonshëm e të jasshtëzakonshëm të shoqërisë, pa asnjë lloj përjashtimi dhe ka të drejtë të kryej të gjitha aktet që i quan të nevojshme për zbatimin dhe arritjen e qëllimeve shoqërore, duke përjashtuar vetëm ato që në mënyrë taksative ligji i rezervon asamblesë.

Këshilli administrativ, ka pra, vëç të tjerave të drejtën e:

- a) blerjes, shitjes, shkëmbimeve të pasurisë së palujtshme
- b) dhënies së pasurisë së palujtshme shoqërive të tjera të krijuara ose që janë duke u krijuar,
- c) dhënies së sigurisë, fidejussioneve, garancisë dhe të mari pjesë në fitime sipas nenit 2 të këtij statuti,



- d) miratimit të regjistrimit, anullimit dhe shënimeve ipotekare,
- e) heqjes dorë nga ipoteka legale,
- f) autorizimit dhe kryerjes së çfardolloj veprimi pranë zyrave publike dhe çdo zyre tjetër private.

#### KAPITULLI V

##### FIRMA DHE PERFAQESTIA SHOQERORE

###### NENI 45

Presidentit të këshillit administrativ ose zëvendëspresidentit i është caktuar përfaqësia e shoqërisë.

###### NENI 46

Presidentit të këshillit administrativ i bie detyra të zbatojë të gjitha vendimet e këshillit administrativ qdo herë që nuk vendo- set ndryshe.

###### NENI 47

Presidenti i këshillit administrativ ose zëvendëspresidenti përfaqëson shoqerinë në gjykim me mundësinë që t'i japi shtytje juridike dhe administrative në çdo nivel, si dhe të emërojë, përsa i takon, avokat e prokuror për paditë.

###### NENI 48

Këshilli administrativ i njeh bashkarisht presidentit dhe zëvendëspresidentit të gjitha kompetencat e parashikuara në nenin 50 të ligjit 7638/92.

NENI 49

Këshilli administrativ ka gjithashtu fuqinë për të emëruar drejtorët, prokuratorët për marrëveshje dhe të autorizuarit në përgjithësi për detyra të përcaktuaar ose kategori detyrash, edhe me të drejtën e delegimit, si edhe arbitra dhe arbitrazh pajtimi në rast mosmarrveshjesh, duke caktuar për secilin nga këta ato detyra, shpërblime dhe pjesmarrje në fitime që vlerëson të orsyeshme.

KAPITULLI VI

EKSPERTET KONTABEL TE AUTORIZUAR

NENI 50

Shogëria do të jetë e kontrolluar nga një organ i përbërë nga një ose tre ekspertë kontabël të autorizuar, të emëruar e të funksionuar sipas normave të nenit 69 të ligjit nr.7638/92 në qoftë se në fund të veprimtarisë shogërore janë kaluar dy nga pikat e më- poshtme:

- totali i aktivit të gjendjes së pronësisë: 12.000.000 lek;
- të ardhurat nga shitjet dhe shërbimet duke zbritur taksën e qarkullimit 24.000.000 lek.
- vartës të punësuar gjatë aktivitetit mesatarisht: 50 .

Ky kontroll do të ndërpritet në qoftë se në veprimtarinë pasuese nuk zbatohen dy nga pikat e mësipërme.

Ky organ, nëse është i përbërë nga më shumë se një person, do të formojë kolegjin e ekspertëve kontabël të autorizuar.

- 14 -

Asamblea e ortakëve kujdeset të emërojë presidentin e kolegjit të ekspertëve kontabël të autorizuar.

**NENT 51**

Ekspertët kontabël të autorizuar e mbajnë këtë detyrë gjashtë vjet dhe janë të rizgjedhshëm.

**NENI 52**

Asamblea në emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar përcakton shpërblimet.

**KAPITULLI VII**

**BILANCI DHE TE ARDHURAT**

**NENT 53**

Veprimtaritë shoqërore mbyllen në 31 Dhjetor të çdo viti.

**NENI 54**

Në fund të çdo veprimtarie këshilli administrativ, brenda 6 muajve, duhet të procedojë në pregatitjen e bilancit shoqëror të përbërë nga gjendja e pronësisë, nga llogaria ekonomike dhe nga inventari.

**NENI 55**

Bilanci shoqëror duhet të pajiset nga një relacion i këshillit administrativ që bën të qartë si ecurinë e administrit mit në sektor të ndryshëm në të cilat shoqëria ka vepruar, edhe me shoqëri të tjera që kontrollohen prej saj, me një kujdes të vecantë si për investimet, për kostot o për çmimet, ashtu

edhe faktave me rëndësi që janë verifikuar pas mbylljes së veprimtarisë.

**NENI 56**

Bilanci shqëror dhe relaciioni i administratorëve duhet të mbeten të depozituar pranë selisë së shoqërisë 15 ditë para mbledhjes së asamblesë së ortakëve, e thirur për t'i aprovuar ato, gjatë së cilës ortakët mund të shqyrtojnë e të kërkojnë kopje me shpenzimet e tyre. Këto dokumenta duhet të janë në dispozicion të ekspertëve kontabël të autorizuar, në qoftë se janë të emëruar të paktën 40 ditë para mbledhjes së asamblesë që duhet t'i aprovojë.

**NENI 57**

Cdo ortak ka të drejtë të marrë nga Asamblea njoftime mbi zhvillimin e punëve të shoqërisë e të kontrollojë librat shoqërorë.

**NENI 58**

Të ardhurat neto, pasi lihet mënjanë një shumë jo më pak se 5% për rezervën e nevojshme, e cila nuk duhet të jetë më shumë se 10% e kapitalit shoqëror (neni 213 ligji 7638/92) shpërndahen ndërmjet ortakëve, përjashto rastin kur asamblea vendos për shpenzime të veganta.

**NENI 59**

Pagesa e të ardhurave duhet të bëhet pranë arkës në selinë e shoqërisë duke hyrë në fuqi nga data e caktuar nga Asamblea e ortakëve që ka vendosur shpërndarjen e tyre.

Në mungesë të përcaktimit të datës fillimit të pagesës të të ardhurave, këto do të janë në dispozicion të shoqërisë pranë

arkës së selisë së shoqërisë duke nisur nga dita e 30 e datës së vendimit të shpërndarjes së të ardhurave ortakëve.

NENT 60

Të ardhurat që nuk janë tërhequr brenda 5 vjeçarit nga dita që janë bërë të zbateshëm parashkruhen në favor të shoqërisë e duhet t'i kalojnë në fondin rezerv.

KAPITULLI VIII

SHUARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

NENT 61

Shoqëria mund të prishet nga një vendim i asamblesë së ortakëve, me votën e ortakëve që përfaqësojnë të paktën 3/4 e kapitalit shoqëror.

Raste të tjera të prishjes janë:

- a) Kalimi i afatit,
- b) Arritja e qëllimit të shoqërisë ose pamundësia për ta arritur atë,
- c) Pamundësia e funksionimit ose vazhdimi inaktiv i asamblesë
- d) Rastet e tjera të parashikuara në nenin 38 e 72 të ligjit 7638/92

NENT 62

Në rastin e prishjes së parakohëshme të shoqërisë anëtarët e këshillit administrativ, datën në të cilën është vendosur shuarja, marrin funksionet e përgjegjësitë e likuidatorëve, me përjashtim të rastit kur asamblea e ortakëve vendos ndryshe.

NENTI 63

Me emërimin e likuidatorit e të likuidatorëve pushojnë funksionet e këshillit administrativ.

NENTI 64

Likujduesi ose likujduesit, emërohen me vendim të Asamblesë së ortakëve të marrë me votën e ortakëve që përfaqësojnë shumicën e kapitalit shoqëror.

NENTI 65

Kohëzgjatja e mandatit të likujdusit nuk mund të kalojë tre vjet, e mund të përsëritet nga asamblea e ortakëve me votën e ortakëve që përfaqësojnë shumicën e kapitalit shoqëror.

NENTI 66

Likujduesi, brenda gjashtë muajve nga data e emërimit të tij, thirret mbledhjen e Asamblesë së ortakëve, të cilës i paraqet reportin për gjendjen e aktivit e të pasivit të shoqërisë para se të fillojë operacionin e likujdimit.

NENTI 67

Likujduesi përfaqëson shoqërinë dhe ka të gjitha kompetencat e nevojshme për llikujdimin e aktivit dhe pasivit të shoqërisë.

Eshëtë i autorizuar të paguaj të gjithë kreditorët dhe t'iu ripërmadajë ortakëve tepricën në dispozicion.

NENTI 68

Likujduesi harton brenda tre muajve pas mbylljes së çdo viti financiar llogaritë vjetore, në bazë të inventarit mbi elementët e ndryshëm të aktivit e të pasivit si dhe një raport me shkrim mbi

administrimin dhe mbi gjithë operacionin e likujdimit gjatë veprimtarisë vjetore.

Asamblea e ortakëve vendos me votën e ortakëve që përfaqësojnë shundicën e kapitalit shoqëror.

**NENI 69**

Shpërndarja e aktivit që tepron pas pagimit të ortakëve të kutoave që zoterojnë nga kapitali shoqëror bëhet ndërmjet ortakëve në përpjestim të drejtë me kontributin e tyre në kapitalin shoqëror.

Nëqoftëse aktivi që do t'u shpërndahet ortakëve përfaqësohet nga pasuri të palujtshme ose impiante ose të drejta si këto, do të proçedohet me shitjen me çmime të njëjta me ato të tregut dhe të ardhurat do t'u shpërndahen ortakëve në përpjestim të drejtë me kuotat e tyre të pjesmarrjes në shoqëri.

**KAPITULLI IX**

**DISPOZITA TE TJERA**

**NENT 70**

Të gjitha mosmarrveshjet që mund të lindin do të zgjidhen në mirkuptim, në të kundërtën do të zgjidhen nëpërmjet Arbitrazhit të Phomës së Tregëtisë në Paris, sipas rregullores së saj.

Ligji që do të aplikohet do të jetë ai zviceran.

**NENI 71**

Për ato që nuk janë shprehur në këtë statut, duhet të bëhet referat me dispozitat e ligjit në fuqi.

Ky statut është kuptuar në katër kopje origjinale në gjithë  
ekzemplar.

Tiranë, më 18.04.1994

P A L E T

Luigj Aleksi *Iber*  
Spartak Causholli *Casimeto*

Giovanni Degennaro

Canio Scianatico

*Canio Scianatico*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E DRYJTESIJËS

NOTERIA

Nr. 8204 Rep.

Nr. 3207 Kol.

V E R T R U T I N

Sot, më dt. .5.1994, para meje noterës u paraqiten personat  
listë: s.Giovanni Degennaro, s.Canio Scianatico, s.Luigj Aleksi, s.  
Spartak Causholli, per identitetin e të cilave u sigurova nga letet-  
njoftimet e tyre personale, madhere, më sotësi te plete juridike per  
te vepruar, se cilët më deklaruan se sa më siper është shkruar sipas  
vullnetit të tyre të lirë që te plete, nenshkruarje regjullist perpa-  
ra meje që tani është shkruar sipas ligjit.

NOTERE

*Shpresa Spoku*

